

Revistë periodike, letrare, kulturore, politike

# NACIONAL

Drejtor:  
Mujë Buçpapaj

Adresa: Ish-kinostudio "Shqipëria e re", Tiranë  
E-mail: nacionalalbania@yahoo.com, bucpapaj@yahoo.com



## TAKIM ME HISTORINË

Për shumë e shumë vite, aspiratat e Shqipërisë për NATO-n shiheshin në të "ardhmen". Tani, e "ardhmja" është sot. Dikur ne flisnim për realizimin "një ditë"...

Nga Xhon Uidhers

faqe nr.4...



## DRITË QË VJEN NGA HUMNERA

Poezi nga Drita Çoma

faqe nr.10...

ZBARDHET PAS 40 VJETËSH  
TAKIM I PANJOHUR I NANËS  
MBRETERESHË  
GERALDINË ME NANËN  
TEREZA

Nga BEQIR SINA

faqe nr.12...

## TEKNOLOGJIA E PROPAGANDËS

Nga Skender BUÇPAPAJ

Për të ardhur tek ne ajo, më e dlira dhe më e përdala, haptas dhe tinës dashnorja e të gjithëve, më zhburruesja dhe më çnjerëzuesja e të gjithëve, më e pashterëshmjia dhe hirplotja, më joshësja dhe tunduesja, më e tejshpuesja dhe më e errëta...

faqe .3...

## TË SYNOSH HIERARKINË POLITIKE?

Nga Nazmi LUKAJ

Kur politika kuptohet si rrugë për të ardhur deri te lumturia (pasuria) jonë, shteti rrezikohet të bjerë në duart e matrapazëve. Ata gjithmonë këtij shteti do t'ia zbazin arkat.

faqe .2...

## AUTOSTRADA DURRËS - PRISHTINË

Nga Vehbi MIFTARI

Andaj, edhe ideja për ndërlidhjen e Durrësit me Prishtinën, e hedhur në vitet e hershme '90 nga Presidenti Rugova dhe Presidenti Berisha, është kërkesë për të promovuar integrimin shpirtëror e fizik të shqiptarëve

faqe .4...

## SHQIPËRIA ETNIKE ËSHTË MIRËQENIE E SIGURI

Nga Gani MEHMETAJ

Debatet dhe përpjekjet për Shqipërinë Etnike bëhen për të krijuar hapësirë të jetesës dhe të veprimit shqiptar me kushte më të avancuara ekonomike...

faqe .2...

# Tomas S. Elioti, Poeti i Tokës, Ajrit, Ujit dhe Zjarrit...

faqe nr.14...



## Mikele Placido, reportazh për një histori shqiptare në Akuila

faqe .12...



Intervistë me Këngëtarin Hajredin Gjeta  
faqe .20...



Intervistë me Këngëtarin Bujar Çiçi  
faqe .20...

SHKENCA PROVON SE ARTISTËT JANË DON ZHUANË TË VËRTETË

AFORIZMA DASHURIE

faqe .21...

## Në BRENDESI

LORDIT ELGIN DHE VEPRA E TIJ

faqe

6-7

Studim nga Gjekë MARINAJ

PIKËLLIMI I PARGËS

faqe

5

Poezi nga Bardhyl LONDO

VDEKJA E VIKTOR QURKUT

faqe

16

Dossier nga Sulejman MATO

POEZI NGA

Khuzepe Hungareti,  
Xhelal Tosku  
Hektor Metani  
Milaim Berisha  
Syhejll Havolli  
Kreshnik Berisha

faqe

11

TREGIME NGA

Musa Tartari  
Albert Zholi

faqe

16-17

KRITIKE LETRARE NGA

Miranda Haxhijaj  
Fatmir Terziu  
Besim Cengu  
Alfred Mulla

faqe

17-22

SPORTELI I GABIMEVE KOMENT

Nga Lindita SEJDIU

faqe

23



Në foto: Gjeke Marinaj

# LARTËSIMI DHE RËNIA E

## Nga Gjekë Marinaj

Kanë kaluar mbi dyqind vjet, që nga koha kur Lordi Elgin morri me vete nga Partenoni një koleksion skulpturash dhe vulosi rrugëtimin e tij në analet e historisë së artit; ndaj sot e kësaj dite versioni më i besueshëm i punës së tij mbetet ende një temë e diskutueshme mbi mosmarrëveshjen midis studiuesve bashkëkohorë dhe kritikëve të artit. Pika kyçe e dallimeve të tilla të rëndësishme mes intelektualëve shpesh herë është frymëzuar nga disa prej lëvizjeve strategjike që kanë arritur mbi këtë temë institucione të veçanta. Ata i dorëzohen përfundimisht pikëpamjeve standarde të çështjes vetëm për të rritur shpresën në mbështetje të teorisë së shumë kërkues, e cila kryesisht ka të bëjë ose me rikthimin e skulpturave në Greqi, ose qëndrimin e tyre për një kohë të gjatë në Londër, në Muzeun Britanik. Kjo nuk ka lidhje me heqjen e vlerave të Partenonit sipas mendimit të kritikëve përballë pragmatistëve të cilët qenë pjesërisht të shqetësuar sepse ndaj tyre "Partenoni ishte më i miri nga ana arkitektonike. Çdo kolonë përmbante nga një koleksion të tablove të zbuluara dhe të gdhendura nga të gjitha anët, të cilat paraqitnin një nga historitë e mitologjisë së Athinës, në njërin anë lindjen e Athinasë dhe në tjetrën betejën e Athinasë me Poseidonin në Atikë. Në pjesën e jashtme të tempullit çdo tablo e vjetër ose zbulime skulpturore kishin të gdhendura skulpturat e skenave në luftërat me perënditë, gjigantët, heronjtë legjendarë dhe centaurët. Ndoshta pjesa më interesante nga brenda tempullit ishte një prej muraleve që sollë përmes barelievit portretin e Panathinës, në një nga ritualet fetare të rëndësishme që organizoheshin çdo katër vjet në Partenon." (St Claire 52). Midis rreshtave të tillë të vështirë vendoset fati i lartësimi dhe rënies të Lordit Elgin dhe koleksionit të skulpturave, duke e paraqitur padyshim si fatalitetin e epokës kritike në art dhe një nga viktimat e kritikave të mbivlerësuar të rebelimit duke shfrytëzuar emrin e tij si gur për të dyja anët e peshores pa marrë parasysh, as karakterin besnik dhe as përgjegjësitë e tij.

Sigurisht që do të ishte e vështirë për të kuptuar natyrën e përgjigjes negative që do të merrnim nga arkitektët dhe artistët e tjerë që kaluan mbi pesëmbëdhjetë vjet nga jeta e tyre për

të ndërtuar Partenonin në shekullin e pestë Para Krishtit, ku nëse një ditë do të thuhej të hiqej kjo vepër arti nga muret e Partenonit prej diplomatit skocez, ndërtesa madhështore do t'i ngjante gjigantit skelet mbi majën e një kodre. Por ndërsa duket tepër dramatike, ka të ngjarë të jenë gëzuar me të vërtetë sepse kanë kuptuar se arti i tyre nuk ishte shkatërruar, por ndodhet në ekspozitën e hapur në Muzeun Britanik me vendndodhje në Londër, në një nga muzetë më të njohura të botës dhe ndër më të vizituarit në planet. Grekët e asaj periudhe do ta kuptonin vlerën e mbijetesës së artit sepse kishin parë relikte të tyre të shkatërruara mizorisht shumë kohë më parë nga persianët dhe më vonë nga osmanët.

Në vitin 1799, kur Thomas Bruce, konti i shtatë i Elginit, morri detyrën si ambasador i Britanisë në Portën Turke të Kostandinopojës, ishte më se në dijeni se në përshkrimin e detyrave të tij nuk paraqitej ruajtja e antikitetit grek. Ndërsa ambicia e Lordit Elgin për të pasur skulpturat ndikoi qëllimin e tij për kryeveprat e premtuara dhe nga ana tjetër mori vet iniciativën për t'i zhvendosur skulpturat nga Partenoni. Me të tilla prova sigurisht që gjatë asaj kohe ndryshoi opinioni i disa grekëve, duke marrë parasysh këtu edhe disa udhëtarë të huaj, por sikurse e thotë Alexander Wilbourne Weddell: "Ka pasuri që i duam dhe u japim vlera aq shumë në këtë botë, sa ngurrojmë t'i shfrytëzojmë, në rast se vlerësimi vështirësohet apo keqësohet do të duhet ta prishim vlerësimin tonë me dashje" (nga Revista National Geographic). Shkurtimisht mbetet e qartë se askush nuk duhet të justifikohet për të shqetësuar të tjerët, por po të marrim parasysh se çfarë do të kishte ndodhur me skulpturat me kalimin e kohës, e gjitha kjo do të ishte më se e shpërblyer.

Zelli i diplomatit Lord Elgin për artin nuk ishte parë as si pikë pozitive, as si rrezik për misionin e tij diplomatik. Për këtë nuk ka asnjë provë që reputacioni i tij ishte sulmuar haptazi nga dikush, përpara se të kryente manovrat e tij me skulpturat. Në të vërtetë para se të zyrtarizohej marrja e vendit të punës për Lordin Elgin, shqetësimet e vetme të njohura prej tij do të ishin shëndeti dhe pasuria. Frika të tilla iu drejtuan sekretarit të marrëdhënieve me jashtë, Lordit Grenville, në një nga letrat e rekomandimit në emër të Lordit Elgin, shkruar nga Henry Dundas:

"Edhe pse jo shumë i suksesshëm, mbetet i pagabuar në postin e tij dhe nuk do të lejonte që vetëm për shkak të rrogës të kërkonte marrjen e vendit të punës. Por në se do të ishte punësuar me vet kënaqësi në punën shtetërore, kjo do t'i sillte gëzim në këtë mënyrë. Nga kjo pikëpamje, ai e konsideron veten plotësisht të paprekur në

duart e qeverisë aktuale. Ai kurrë nuk do t'ju mbështeste të bënit diçka, as nuk do t'ju shfaqte shenja mashtrimi, por do ta gjenit në çdo kohë të gatshëm për të ndjekur të gjitha kërkesat që kam shprehur me mendimet e mia." (cituar nga St Claire, 3).

Sidoqoftë, destinacioni për të shkruar në Kostandinopojë e pajisi Lordin Elgin me një energji të brendshme që i rriti shpresën përtej imagjinatës. Klima e Detit Mesdhe ishte shumë e përshtatshme për shëndetin dhe karriera e tij politike nisi të hyjë drejt një rruge tërësisht të re, po të mos përmendim faktin se "Paga e Lordit Elgin ishte caktuar me shumën 6 600 £ në vit" (St Claire 11). Shkurtimisht, "kur i thanë të shkonte në Kostandinopojë, Elgini kishte arsye të parashikonte se karriera e nisur me aq profesionalizëm, ishte vetëm në hapat e para" (St Claire 4).

Fillimisht, Lordi Elgin dukej se ishte tepër i kënaqur me mundësinë e do t'i jepte lejen të nxirrte riprodhimet e skulpturave klasike të Akropolit. Për një pune të pafrytshme për të marrë mbështetjen ligjore, ai punësoi artistin më të mirë së bashku me piktorin talentuar Giovanni Lusery-in që ndihmonin me punën dhe i paguanin me sa mundte. Duke përfutur nga autoriteti britanik ndaj forcave të armatare franceze në Egjipt, Lordi Elgin zgjodhi mundësinë e shkëlqyer për të kërkuar osmanëve leje për të çuar në Angli koleksionin e skulpturave origjinale. Ai mendoi se punët e tij do pranoheshin seriozisht nga shteti dhe populli anglez si ndihmë jashtëzakonisht e madhe për artin britanik. Duke pasur shpresa të tilla, nuk kemi bëmë me asnjë shenjë frike nga ndonjë ndryshim mendimi. Lordi Elgin nuk ishte diplomati i parë që kërkoi leje për të lëvizur dhe thesareve të antikitetit nga Greqia. Sipas St Claire, "The Comptroller de Choiseul-Gouffier kishte qenë ambasadori francez dhe gjatë asaj kohe zotëronte lidhje të ngushta me shtetin osman dhe rastësisht në shenjë mirënjohjeje, turqit e kishin pranuar të mbanin nën kontroll tregtinë e antikeve në Francën" (St Claire 15). Sipas logjikës, po të kishte ndodhur një herë, do të ndodhte sërish, apo jo?

Meqë kishte njohuri shumë të mira se çfarë modeli duhet të ishte arti i përsosur, veç aftësisë së Lordit Elgin për të vendosur vlera unike rreth rëndësisë historike të koleksionit të skulpturave, mbi të gjitha u gëzua se mori lejen për skulpturat e Partenonit. Në të vërtetë, "... nuk ishte pjesë e marrëveshjes kryesore për të hequr një prej koleksionit të skulpturave, por kur zbuloi se sa shpejt po prisheshin nga pakujdesia, nga dëmtimet dhe po u shiteshin pak nga pak për një copë buke udhëtarëve kalimtarë, mori leje të hapur dhe të plotë nga administrata shtetërore turke për t'u vepruar në këtë

mënyrë" (Trustees 7). Përveç idesë se kjo punë lindi nga frymëzimi i popullit, në të gjitha aspektet e jetës, në një nga diskutimet e ashpra për kontratën e ekspozimit të plotë, ai do të respektohej për interesimin e jashtëzakonshëm që tregoi në ruajtjen e veprave të artit. "Historia e Elginit është një nga historitë më prekëse, sepse besonte se po u jepte prova fisnikërie brezave të ardhshëm për mbrojtjen e koleksionit të skulpturave të Partenonit nga harresa me zhvendosjen e tyre" (Jackson 135).

Kur Lordi Elgin u takua me Sir Uilliam Hamiltonin në vitin 1799, vlerësoi atë që Sir Hamiltoni kishte bërë ndërsa ishte Ambasador në Napoli, i cili në emër të artit dhe arsimit anglez kishte koleksionuar vazo, monedha dhe antike të ndryshme. Fakti që Sir Hamiltoni kishte falimentuar financiarisht nuk e shqetësoi Lordin Elgin që në çastin kur u takuan, por e çoi në

sonale, pavarësisht nga qëllimet e vërteta. Nga ana tjetër, vetë historia ka vërtetuar se ndonjëherë është më mirë të flijohesh për hir të artit. Greqia nuk ishte më ndryshe nga vendet e tjera si; Egjipti, Shqipëria dhe Italia, vende të cilat kishin pësuar humbje të mëdha të pasurive kombëtare. Në të njëjtën mënyrë, "beteja franceze e Italisë kishte trazuar si botën artistike, ashtu edhe atë politike. Muzetë ishin shkatërruar dhe gjithë veprat më të mira të artit u dërguan në Luvër. Antiket më të njohura të shekullit të 18-të, Laokonti, Apoloni në Belvederë dhe Venis de Medici (perëndesha e dashurisë Afërdita) u blenë nga Italia sikurse edhe disa nga pikurat më të mira." (St Claire 36).

Në se Lordi Elgin nuk do ta kishte sjellë në Angli koleksionin e skulpturave, kjo do të mundësonte që veprat e artit të keqtrajtoheshin nga mungesa e përkujdesjes ose për shkak të luftës për pavarësi të Greqisë nga



një nivel më lart sepse e njohu me originalitetin e qeramikave dhe interesin e përbashkët për ekspozimin e artit në një vend si Muzeu Britanik, i cili do të ishte i hapur për këdo. Lordi Elgin ishte nxitur nga pozita e lartë dhe qëndrimet personale kur fliste për artin në përgjithësi, ku "pa dyshim që kishte qëllime në mbrojtje të arkitekturës dhe skulpturës ashtu siç kishte Hamiltoni me punimin e qeramikës," (St Claire 28).

Nga pikëpamja morale, Lordi Elgin ishte në dijeni se do të sulmohej ngaqë kishte ndihmuar trazirën politike dhe kishte përdorur reputacionin politik në vendin e tij për fitime per-

protesta e Mesdheut për shfarosjen e forcave ushtarake osmane. "Një numër i madh i skulpturave zbuluara u prishën qëllimisht nga rritja e ikonoklazmit (ikonatherjes) të rregullt" (St Claire 52). Pa dyshim që, "Partenoni po duronte regjimin turk në Greqi" (Jackson 135), i cili tregon se do të ketë një tjetër mundësi që do ta çojë përfundimisht koleksionin e skulpturave në një shtëpi tjetër, të cilën vetëm Zoti e di se ku, në vendin që do të ekspozoheshin për këdo, në një nga vendet më të vizituara në botë, në Muzeun Britanik të Londrës. "Perandoria Osmane e cila kishte sunduar në Athinë për 350 vjet nuk kishte asnjë lidhje të veçantë me shkëlqimin që

# LORDIT ELGIN DHE SKULPTURAT E TIJ

zotëronte Greqia së bashku me Akropolin” (Jackson 137). Me sa dimë marrja në konsideratë e përgjegjësisë për largimin e skulpturave i dha frymëzim vetëm Elginit.

Fillimi i shekullit të 19-të ishte njollë e zezë për historinë greke. Nga disa studime historike të periudhës thuhet se grekët e asaj epoke, nuk i vlerësonin aq shumë skulpturat, aq sa i mbivlerësojnë grekët e sotëm dhe disa nga studiuesit ndërkombëtarë. Një diskutim i tillë merr kuptim duke marrë parasysh se osmanët i kishin detyruar intelektualët grek të emigronin në vende të tjera të Evropës. Fondet për arsimin ishin kufizuar për shkak të veprimtarive në Kishën Ortodokse. Madje fëmijëve u duhej të shkonin në shkollë natën dhe të flinin ditën, vetëm për të mbajtur të gjallë gjuhën dhe kulturën greke nga brezi në brez. Pjesa më e madhe e popullsisë punonte tokën dhe bënte punë të tjera të za-

parimet dhe niveli i qytetarisë së asaj epoke sundoheshin nga kriza e padëgjues ndonjëherë në Greqi. Ajo përshkruhet më së miri në letrën që Zonja Elgini i shkroi nënës duke shpalosur aftësitë e saj në atë vend. “Gratë e haremit dukej se argëtoheshin me sjelljen dhe veshjen time. Njëra prej tyre m’u afrua dhe më solli një brokë me ujë mbi tabaka, ndërsa të tjerat paturpësisht më preknin flokët, gurët e çmuar, krahët” (Vrettos 86). E ndodhur pranë prekjeve të tilla, është absurde të presësh vlerësim të lartë për vetë jetën e aq më pak për artin.

Falë keqkuptimeve për punën e tij nga disa persona të rëndësishëm të asaj kohe, aty rreth të pesëdhjetave, jeta e Elginit pësoi një fatalitet të padëshirueshëm. Gjatë kthimit në Greqi, me anijen që bleu për të transportuar skulpturat në Angli u fundos në mes të detit dhe bashkë me të edhe

shpresa e Lordit Elgin. Gjatë kthimit në Angli, “përveç statusit të diplomatit, Elgini u kthye në robin e luftës dhe për një farë kohe u burgos në një kësh-tjellë” (Jackson 138). Por megjithatë edhe kjo gjë nuk e ndali nga misioni dhe nuk ia ndryshoi përkushtimin për artin që e donte me aq shumë zell, aq sa ishte gati të shpenzonte gjithçka që kishte, sado e pamundur të dukej:

“Pas kthimit të tij nga Franca në vitin 1806, jeta e Lordit Elgin ndryshoi plotësisht. Ndërsa ishte i izoluar nga jeta publike prej humbjes së vendit në Parlament në Dhomën e Lordëve

dhe premtimit të dhënë Napolonit, detyrohej të mos e vizitonte aq shpesh Londrën. Ndryshimi i pozitës e bëri të tërhequr nga shoqëria, por edhe jeta në vend nuk ishte më ajo që kishte qenë në kushte më të mira. Ai nuk mund t’ia dilte më të mbante Pallatin Broomhall, ashtu siç kishte bërë Harrisoni në vitet 1790-të, për të cilën pjesa më e madhe mbeti e pamobiluar. Disa prej shërbëtorëve u pushuan nga puna dhe Elgini jetoj me sa kishte mundësi në paqe dhe pa shumë shpenzime në një nga mjediset e pallatit” (St Claire 181).

Fatkeqësisht shqetësimet e Lordit Elgin nuk mbaruan këtu. Më pas ai zbu-

loi se bashkëshortja e tij kishte një marrëdhënie dashurie me Fergusonin ku edhe pse “pa marrëdhënie seksuale” si e vetmja mënyrë me të cilin mund të qëndronte, sërish martesë e tyre përfundoi në mënyrë të pakëndshme.

Fillimisht e vetmja shpresë që kishte për t’u rikthyer disa borxhe ku u ishte zhytur borxhlinjë të tij ishte shitja e skulpturave Muzeut Britanik. “Edhe pse në të vërtetë nuk u pagua për to, shpenzimi i marrjes së lejes, i realizimit të punës dhe i transportimit të tyre ishte baras me 75 000 £” (Trustees 7), e cila ishte dy herë më shumë se sa mund të mblidhte nga Muzeu Britanik.

Një nga arsytet më të mëdha pse Lordi Elgin nuk u konsiderua hero për punën e tij në mbrojtje të skulpturave të Partenonit dhe pasurimit të Muzeut Britanik në Londër ishte lufta e ndërlikuar me të cilën u përball me udhëtarët e huaj, kritikët e artit dhe veçanërisht poetët e asaj periudhe. Më shumë se sukses i Lordit Elgin ishte tërheqje tepër e zakonshme e natyrës greke dhe fuqisë magjike të vetë skulpturave që prekën zemrat e njerëzve që ishin gati të shprehnin ndjenjat e tyre në librat, gazetatat dhe revistat e asaj kohe. Mendimet e shkrimtarëve dhe poetëve u rritën sipas pozitës së reputacionit të lartë që zinin në shoqëri.

“Kushdo që ishte i ndjeshëm ndaj informacionit historik, cilido që të bukuren e konsideronte si thirrjen më të lartë, skena e parë e qytetit të përjetshëm do të kthehej në jetën reale,” shkruar nga Alexander Wilbourne Weddell, ish Konsull i Përgjithshëm i SHBA-ve në kryeqytetin e Greqisë, në një nga numrat e revistës, muaji dhjetor, viti 1922, në artikullin e titulluar “Lavdia që quhej Greqi” (Wintraub National Geographic). Veç kësaj, për të prishur imazhin publik të Lordit Elgin, kritikë i artit Richard Payne Knight përmendi idenë e çmendur se skulpturat ishin romake dhe jo greke. Nga ana tjetër ishte poeti romantik Lordi Bajron si një nga kritikët më të njohur dhe më të fuqishëm, i cili ishte ndër të privilegjuarit më të famshëm të kulturës dhe qytetërimit grek” (Jackson 135). Ai ishte ndër poetët më të vlerësuar dhe të njohur në botë. Edhe pse Bajroni nuk kishte ndërmend të botonte poemën e tij të famshme “Mallkimi i Minervës”, një sinjal i tillë e shqetësoi aq shumë, sa Bajroni i shkroi botuesit John Murray, më 6 mars 1816, duke i kërkuar që poema të mos botohej dhe as të pranohej për botim,” (J.G.Hawaii Publishing Co), e megjithatë botimi i poemës pati ndikime negative të jashtëzakonshme për reputacionin e ardhshëm të Lordit Elgin. Opinioni i tij ndaj kësaj çështje ndryshoi pikëpamjen e shumë prej atyre që ishin të pavendosur për të kundërshtuar titullin e Lordit Elgin që lidhet me



Lordi Elgin, në vitin 1787

zhvendosjen e veprave të artit nga Partenoni në Angli. Më poshtë do të lexoni një fragment nga poema:

## “MALLKIMI I MINERVËS”

...Si fillim vjen në mendjen dhe farën e tij:  
Mallkimi do ta godasë si atë dhe farën:  
Pa shkëndijën e zjarrit intelektual,  
Qofshin gjithë bijtë po aq të marrë sa mbreti:  
E nëse ndonjëri ndot familjen e atit me shaka,  
Besojë po deshe bastard i racës së mençur:  
Prapë ata pseudo artistët, do të thonë shko!  
Me lavdinë e të marrit, blen urrejtjen e të urtit;  
Ku prej zellit të madh nga talenti thotë,  
Cilin zell të shes, atë të drejtësisë, apo të qytetarit?  
Ta shes dhe të bëj famë, ndot vërtetësinë e ditës!  
Në çastet e marrjes së viktimës së grabitur...”  
(Lord Bajron. cituar nga Hawaii Publishing Co).

Shumica e njerëzve mendojnë se nëse Lordi Elgin do të kishte mbështetur Lord Bajronin, Elgini do të ishte po aq i famshëm dhe i vlerësuar në art për Anglinë, sa ishte Napoloni me çlirimin e Francës.

Ndërsa sot një nga arsytet që diskutojmë mbi të gjitha fatin e skulpturave qëndron në kushtet e ekzistencës dhe sigurisë së tyre që ilustron faktin se një ekip i zgjedhur me kujdes nga vetë Lordi Elgin zhvendosi skulpturat nga Partenoni me miratimin e profesionalizmit të artit dhe mirënjohjes. Një e vërtetë e tillë duhet të merret në konsideratë nga disa prej studiuesve që kanë kaluar në radikalizëm ndaj Lordit Elgin. Pas dyqind viteve, njerëzit nuk do të gjejnë tolerancë ndaj diskutimeve të tilla për skulpturat gjigante të Budës që u shkatërruan mizorisht nga fundamentalisti afgan vitet e fundit. A nuk do të ndiheshim më mirë nëse ndokush do t’i çonte në një vend më të sigurt që të vizitoheshin në çdo kohë, kudo në botë, qoftë edhe nëse do të duhej të flitej për procedurën ligjore apo paraqitjen e dokumentit?

Përktheu nga anglishtja: Irena Papingji



Pavarisht vleres arkitektonike dhe rëndësisë historike që simbolizonte koleksioni i skulpturave, grekët kishin një arsye më shumë të besonin se në gjendje statike, vlera e vërtetë e skulpturave do të binte shumë. Të tilla përfundime kanë kuptim sa për faktin se “... në artin e asaj kohe, simbolizohet vetëm qenia e përsosur njerëzore” (Yalouris VII), aq edhe sepse në vend që të vlerësohej arti në shkallën e merituar, kërkonte veç nivelit të caktuar të shkollimit, edhe ndjesi artistike. Kjo nuk është për t’u diskutuar pasi “greqët mendonin se arti është thjesht një mjet ose për t’u kënaqur, ose për t’u mësuar, por njëkohësisht është fryt i një lëvizjeje plotësisht fetare” (Yalouris VII). Megjithatë duhet të kujtojmë se